VENDIM
Nr. 292, datë 13.11.2025

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË OST SHA PËR MIRATIMIN E "KODIT TË RRJETIT MBI EMERGJENCËN DHE RIVENDOSJEN"

Në mbështetje të neneve 16, 20, germat "a", 23, pika 1, germa "b", 30, pika 2, dhe 90, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 26 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.11.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2159/1 prot., datë 24.10.2025, të përgatitur nga drejtoritë teknike, "Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. për miratimin e 'Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2196 e 24 nëntor 2017, 'Për krijimin e Kodit të Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen'"",

konstatoi se:

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. 2903 prot., datë 26.5.2025, protokolluar në ERE me nr. 1739 prot., datë 30.5.2025, ka depozituar kërkesën për miratimin e "Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2196, datë 24.11.2017, 'Për krijimin e Kodit të Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen'".

- Në këtë kërkesë, OST sh.a. informon se Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë, në mbledhjen e datës 14–15 dhjetor 2022, ka miratuar vendimin nr. 2022/03/MC-EnC, përmes të cilit kjo rregullore është përfshirë në *acquis communautaire* të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, si pjesë e Paketës së Energjisë së Pastër.

- Rregullorja (BE) 2017/2196, e njohur si Kodi i Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen, vendos një kornizë të harmonizuar për menaxhimin e situatave emergjente dhe procedurat e rivendosjes së sistemeve të transmetimit në nivel rajonal dhe evropian, duke përcaktuar rregulla të detajuara për operatorët e sistemeve të transmetimit dhe strukturat rajonale të koordinimit të sigurisë. Qëllimi i saj është të sigurojë operimin e sigurt, stabilitetin dhe rikuperimin e sistemit elektroenergjetik në raste emergjencash.

- Rregullorja përcakton rregulla të qarta dhe të detajuara për operatorët e sistemeve të transmetimit, lidhur me menaxhimin e emergjencave, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit në kohë reale, si dhe koordinimin e veprimeve për rivendosjen e sistemit pas ndërprerjeve, incidenteve ose kontigjencave.

- Gjithashtu, kjo rregullore përmban kërkesa të detajuara për menaxhimin e situatave të jashtëzakonshme në sistemin elektroenergjetik. Ajo synon të sigurojë që sistemet elektroenergjetike të mbeten të qëndrueshme dhe të rikuperueshme në rast emergjencash ose kolapsesh të plota *(blackout),* nëpërmjet një qasjeje të koordinuar në nivel kombëtar dhe rajonal.

Në përputhje me legjislacionin e Komunitetit të Energjisë dhe nevojën për harmonizim me rregullat e BE-së, ERE vlerëson të nevojshme nisjen e procedurës për shqyrtimin e kërkesës dhe organizimin e seancave dëgjimore dhe të konsultimeve me palët e interesuara, përfshirë institucionet dhe aktorët e tregut të energjisë, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

- Nëpërmjet *email*-it të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, datë 24.7.2025, janë përcjellë pranë ERE-s komentet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, në kuadër të procesit të miratimit të ndryshimeve në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar. Këto komente kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për mënyrën e transpozimit të udhëzimeve dhe rregulloreve të Paketës së Energjisë së Pastër, përfshirë aktet mbi balancimin

(EBGL), alokimin afatgjatë të kapaciteteve (FCA), si dhe operimin e sistemit (SOGL) dhe emergjencat dhe rikuperimin (NC ER).

- Në vijim të komenteve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, të përcjella nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë më datë 24.7.2025, vlerësohet se këto sugjerime kanë rëndësi të veçantë për qasjen e ndjekur nga ERE në transpozimin e Kodit të Rrjetit dhe Udhëzimeve të Tregut, përfshirë rregulloren në fjalë. Komentet theksojnë nevojën që detyrimet që rrjedhin për OST sh.a., NEMO dhe autoritetet rregullatore të jenë të përcaktuara qartë në nivelin përkatës ligjor, si dhe të sigurohet koordinim i plotë me dispozitat mbi ACER-in, metodologjitë e përbashkëta (TCMs), çështjet ndërkufitare dhe qendrat rajonale të koordinimit (RCC).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e "Kodit të Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen".
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti